



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 95 paragrafi 2, nenin 96 dhe nenin 97 paragrafi 1 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) numër 27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Pozita:	Shtëpiak
Arsimimi i kërkuar:	Shkollimi i mesëm
Lloji i pozitës:	Nëpunës Teknik dhe Mbështetës
Klasa dhe koeficienti i pagës:	Klasa e Pagës GJ50, Koeficienti 3.8
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Drejtoria:	Drejtoria e Administratës
Spektori:	Spektori për Teknologji Informative dhe Logjistikë
Data e njoftimit:	30.03.2026
Afati për aplikim:	31.03.2026 – 14.04.2026
Numri i referencës:	01-111/01-14855
Kohëzgjatja e kontratës:	Kontratë me periudhë të pacaktuar.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe rregullimin e defekteve në objektin të Komunës së Gjakovës dhe objektet vartëse.
- Mirëmban rrjetin elektrik, ujësjellësin dhe kanalizimet.
- Mirëmban sistemin e ngrohjes qendrore dhe klimatizimit.
- Bën rregullimin e cilindrave të dyerve, dritareve, etj.
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- Arsimimi i kërkuar: **Shkollimi i mesëm.**
- Kërkesat specifike: **Nuk ka.**

- c. Përvoja e punës e kërkuar: **Nuk kërkohet.**

4. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Ambientet e Shërbimit me Qytetarë*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet fizikisht në *Sektorin për Administrimin e Dokumenteve* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. **Formulari i aplikimit, i plotësuar.**
- b. **Kopjet e dokumentit personal** (*letërnjoftim ose pasaportë*).
- c. **Kopjen e diplomës** të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vendimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit e kontratës në këtë pozitë.
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit.
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- a. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- c. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*).
- d. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

6. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Vlerësimi i jetëshkrimit (*deri në 30 pikë*)
- b. Intervistë me gojë (*deri në 70 pikë*)

7. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (gjakova.rks-gov.net), portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>), postën elektronike ose numrin e telefonit të deklaruar në aplikacion.

8. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- d. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.